

How I got to know Peter Bartl

Abstract: In his trip down memory lane, Prof. Jochalas recalls the days when he first met Prof. Peter Bartl at the *Albanien Institut* in Munich in 1970. Professionally headed by Georg Stadtmüller, balkanologist, the true spirit of the *Institut* was Peter Bartl in fact.

He was the first to arrive at the *Institut* in the morning and the last to leave it in the evening. Bartl founded a library rich in books about Albanology and he would take care about the catalogisation of the newest books, magazines and journals.

The famous collection of *Albanische Forschungen*, founded and edited by Prof. Stadtmüller joined this library mainly because Bartl showed interest in it to be acquired.

Keywords: *Peter Bartl, Albanische Forschungen, Georg Stadtmüller, Albanien Institut.*

Me një formim akademik italo-grek dhe falë një burse të parë modeste gjermane, kisha mbërritur në Munih në muajt e fundit të 1970 për të zgjeruar njohuritë e mia të kufizuara në Albanologji dhe për t'i zhvilluar ato më tej metodologjikisht.

I veshur me një pardesy shiu të lehtë italiane, që sigurisht nuk ishte e mjaftueshme për temperaturat e ftohta në Bavari, u paraqita në “Albanien Institut” për të njohur nga afër Prof. Georg Stadtmüller, një ekspert i mirënjohur në Ballkanologji. Nuk mund ta mohoj se i gjendur përballë tij, që me pamjen e tij serioze dhe hijerëndë zotëronte gjithë Institutin, ndjeva njëfarë sikleti.

Në derën e zyrës Prof. Stadtmüller kishte vendosur një tabelë ku shkruhej “Shefi është gjithnjë i pranishëm”, çfarë më zbrapste prej bisedave të këndshme e shplodhëse me sekretaren, zonj. Paerisch, e cila dukej joelastike, në fakt kundër dëshirës. Një një moment të tillë, as edhe buzëqeshja gjithsesi e shtirë e bashkëpunëtorëve të shumtë të Profesorit nuk arrinte ta thyente akullin. Vetëm fytyra e qeshur dhe e përzemërt e Peter Bartl munda më në fund të më largonte drojën.

Pas një kohe të shkurtër kuptova se ai ishte “shpirti i vërtetë” i *Albanien Institut*. Ai punonte në mënyrë të palodhur dhe metodike, dhe ishte i pari

që vinte mëngjeseve në Institut dhe i fundit që largohej mbrëmjeve prej aty. Kishte ngritur një bibliotekë albanologjike shumë të pasur, kujdesej ditë për ditë për katalogizimin e hyrjeve të reja dhe më pas për publikimin e katalogut të librave e revistave. Është për të ardhur keq, që komuniteti universitar bavarez ka lejuar largimin prej aty të këtij “Thesaurus” albanologjik.

Edhe seria e jashtëzakonshme dhe mjaft e pasur e “Albanische Forschungen”, (Kërkime shqiptare - shën. përkth.), e themeluar prej Prof. Stadtmüller, erdhi kryesisht falë mbështetjes dhe përkushtimit të palodhur të Peter Bartl. Edhe sot e kësaj dite kjo seri është një fanar shkencor, që ndriçon e mbetet aktiv gjithnjë.

Unë i jam mirënjohës Peter Bartl për vëmendjen që ka treguar ndaj meje dhe për pranimin në rrethin e rëndësishëm të kolegëve shkencorë të tij.

E ndërsa jam duke hartuar kumtesën në italisht për nder të tij, shpresoj se jam duke i bërë qejfin, sepse gjatë gjithë jetës së tij Peter Bartl ka pasur një marrëdhënie të ngushtë me gjuhën italiane, përmes kërkimit këmbëngulës shkencor dhe botimeve ekzemplare të dokumenteve nga arkivat e Vatikanit dhe ato italiane.

Përktheu nga gjermanishtja Raim Beluli